

KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

Në Elbasan, sot më datë 22/10/2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), prane selise se subjektit "Sama Construction" me adrese ne Elbasan, ish Uzina 12, Metalurgji, ne palet e meposhtme redaktojme kete kontrate shitblerjeje kuotash të kapitalit të shoqërisë:

SHITËSI: Z. Staver Prifti, atësia: Todi, i datëlindjes 25.08.1950, lindur në Lushnje e banuese ne Tiranë, identifikuar sipas ligjit me Leternjoftimin ID nr. 028226588 dhe nr. personal F00825046A, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakut të shoqërisë "SAMA CONSTRUCTION" Sh.p.k., themeluar si person juridik në datën 15.07.2015, me NUIS: L53116202S;

BLERËSIT:

Z. Juljan Prifti, i biri i Staver-it, i datëlindjes 26.02.1976, lindur ne Lushnje dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit Nr. 027618966, me numer personal H60226056C.

Znj. Etleva Prifti, e bija e Staver-it, e datëlindjes 21.03.1973, lindur ne Divjake, Lushnje dhe banues ne Kavaje, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit Nr.031412289, me numer personal H35321082W.

Z. Endrit Prifti, i biri i Staver-it, i datëlindjes 21.11.1982, lindur ne Elbasan dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr.BB8767743, me numer personal I21121028O

NENI 1

Shitësi është ortak me zotërues i 1 kuote, me vlere 1 000 (njemije) leke, me pjesëmarrje 100% të kuotave, të shoqërisë "SAMA CONSTRUCTION" Sh.p.k., regjistruar si person juridik në datën 15.07.2015, me NUIS: L53116202S, me seli në Elbasan, Ish Uzina 12, Metalurgji.

1.1 Këto kuota të shoqërisë, Shitësi ia shet Blerësve te cilët pranojnë t'i blejnë ato sipas çmimit dhe kushteve të përcaktuara më poshtë në këtë kontratë.

1.2 Nga këto kuota të kapitalit themeltar të shoqërisë "SAMA CONSTRUCTION" Sh.p.k. që ai zotëron, Shitësi u shet Blerësve 100% të tyre, me vlerën e tyre të cilët pranojnë t'i blejnë ato, sipas kushteve dhe proporcionit të përcaktuar më poshtë në këtë kontratë.

NENI 2

2.1 Çmimi i shitjes së kuotave në pronësi të Shitësit, të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë "SAMA CONSTRUCTION" Sh.p.k., është në vlerën e tyre nominale.

2.2 Ky çmim është likuiduar nga Blerësit kundrejt Shitësit, dhe Shitësi deklaron se e ka marrë këtë çmim dhe nuk ka asnjë pretendim në lidhje me pagesën e tij ndaj Blerësve.

NENI 3

3.1 Blerësit, i blejnë kuotat që shet Shitësi, në raportin e mëposhtëm:

Z. Juljan Prifti, blen 33.34 % të kuotave, kundrejt çmimit të tyre nominal prej 333.4 Lekë, dhe bëhet ortak me 33.34 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë "Sama Construction" Sh.p.k.

Znj. Etleva Prifti, blen 33.33 % të kuotave, kundrejt çmimit të tyre nominal prej 333.3 Lekë, dhe bëhet ortak me 33.33% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “Sama Construction” Sh.p.k.

Z. Endrit Prifti, blen 33.33 % të kuotave, kundrejt çmimit të tyre nominal prej 333.3 Lekë, dhe bëhet ortak me 33.33% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “Sama Construction” Sh.p.k.

3.2 Me realizimin e kësaj shitblerje të 100% të kuotave të shoqërisë “Sama Construction” Sh.p.k., Blerësve u transferohen proporcionalisht të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga blerja e tyre, ndërsa Shitësi largohet nga pjesëmarrja e mëtejshme në shoqëri.

NENI 4

4.1 Shitësi deklaron se është pronar me të drejta të plota mbi kuotat që i transferon Blerësit; nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e tyre apo që t'i ketë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi to deri në datën e sotme; ai i shet këto kuota të kapitalit të shoqërisë Blerësit të lira nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë; të drejtat mbi to, nuk janë të përfshira në procese civile, penale, administrative, arbitrazhi apo të çfarëdo lloji natyre tjetër që të mund të jetë shkak për cënimin e kontratës apo titullin e pronësisë së Blerësit mbi to.

NENI 5

5.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.


5.2 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.


5.3 Kjo kontratë hartohet në kater njësi origjinale të cilat kanë të njëjtën përmbajtje dhe vlerë ligjore, prej të cilave nga 3 njësi i mbajnë palët dhe një njësi depozitohet pranë QKR-së .Ne Palët deklarojme se kuptojme dhe se e pranojnë këtë kontratë, pasi ajo është në përputhje me vullnetin tone të lirë dhe të plotë dhe e nënshkruajmë atë rregullisht.

PALËT KONTRAKTORE

SHITËSI

z.Staver Prifti





BLERËSI

z. Juljan Prifti


Znj. Etleva Prifti


z. Endrit Prifti

